



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 779/5 prot.

Tiranë më 22.6.2021

URDHËR

Nr. 91, datë 22.6.2021

PËR KONTROLLUESIN "PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Partia Bindja Demokratike*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 74, datë 28.05.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye vijim-hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Partia Bindja Demokratike*" (në vijim, "*Kontrolluesi*"), më datë 03.06.2021, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit, konstaton se:

1. Në kuadër të fushatës për zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në datë 25.04.2021, "*Partia Bindja Demokratike*" ka publikuar në llogarinë e vet në kanal youtube.com, spotin publicitar me titull "*Voto për një rini me mundësi të barabartë*", më datë 09.04.2021, me lidhje (link) marrë nga faqja më poshtë:
<https://www.youtube.com/watch?v=d8ME8NMmJSo>.

Referuar ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se Kontrolluesi ka krijuar dhe publikuar video-spote në lidhje me këtë subjekt politik, në kontekst të zgjedhjeve parlamentare

të datës 25.04.2021, në përmbajtje të të cilit ndodhet edhe imazhi-video i ankueses, pa pëlqimin e saj.

Video-spoti është publikuar më datë 09.04.2021, në llogarinë e këtij subjekti politik marrë nga faqja më poshtë: <https://www.youtube.com/watch?v=d8ME8NMmJS0>. Imazhi i ankueses shfaqet gjatë intervalit kohor 0.07 – 0.10 sekonda nga 31 sekonda në total.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, Kontrolluesi nuk provoi pëlqimin e subjektit të të dhënave (ankueses), për të qenë pjesë e video-spotit të fushatës elektorale për “Partinë Bindja Demokratike”, në kundërshtim me parashikimin në pikën 24 të nenit 3 dhe germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim “Ligji”).

Në këtë rast, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i mësipërm (publikimi) i të dhënave të ankueses, nuk gjen mbështetje në asnjë parashikim ligjor konkret me qëllim që të konsiderohet i ligjshëm. Kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë/publikojë të dhëna personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të Ligjit,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi të realizojë në mënyrë të menjëhershme, fshirjen e imazhit të ankueses nga spoti publicitar me titull “Voto për një rini me mundësi të barabartë”.
2. Kontrolluesi mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrës së lënë në këtë Urdhër, brenda 5 ditëve.

Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

3. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 22.06.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

